

## VENDIM

Në bazë të Ligji Nr. 04/L57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe Nenit 26 të Statutit të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës të vitit 1999, në Mbledhjen vjetore më datë 28.04 2016 të mbajtur në Prishtinë ,  
Kuvendi i Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës miratoi ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të sajë si:

### STATUTI I ASOCIACIONIT TË ARKITEKTËVE TË KOSOVËS 2016

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë, nga data 28 Prill 2016.



Ilir Murseli  
Drejtor Ekzekutiv  
Person i autorizuar  
Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës





# STATUTI

I

Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës



2016



Në bazë të Ligji Nr. 04/L57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe Nenit 26 të Statutit të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës të vitit 1999, në Mbledhjen vjetore më datë 28.04 2016 të mbajtur në Prishtinë, Kuvendi i Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës miratoi ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të sajë si:

## STATUTI I ASOCIACIONIT TË ARKITEKTËVE TË KOSOVËS

### 2016

Organizimi i arkitektëve në formë të shoqatës në territorin e Kosovës ka nisur në vitet 60' të shek.XX. Në fillim të viteve 80' krijohet Shoqata e Arkitektëve të Kosovës si pjesë e Lidhjes së Arkitektëve të Jugosllavisë, lidhje e cila shuhet në fund të viteve 80'. Gjatë viteve të 90' Shoqata e Arkitektëve të Kosovës mbijetoi si të gjitha institucionet e Kosovës. Menjëherë pas mbarimit të luftës së vitit 1999, anëtarët e Shoqatës së Arkitektëve të Kosovës kanë pasur disa mbledhje në lidhje me riorganizimin dhe vazhdimin e funksionimit të sajë. Në Dhjetor 1999 Shoqata organizon Mbledhjen e Kuvendit në të cilin aprovohet Statuti dhe emri i ri i shoqatës si Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës AAK (Association of Architects of Kosovo), dhe në Mars të vitit 2000 regjistrohet si Organizatë Jo Qeveritare.

#### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: **aak**) është organizatë joqeveritare, joprofitabile dhe profesionale në bazë vullnetare në të cilën janë të bashkuar arkitektë të Republikës së Kosovës.

##### Neni 2

**aak** është person juridik, me kompetenca të plota publike sipas ligjeve në fuqi për organizatat jo qeveritare në Republikën e Kosovës.

##### Neni 3

- 1) Emri i plotë i **aak** është: Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës
- 2) Selia e **aak** është në Prishtinë.
- 3) **aak** përdorë emrin e plotë në gjuhën serbe: Asocijacija Arhitekata Kosova.
- 4) **aak** përdorë emrin e plotë në gjuhën angleze: Architects Association of Kosovo.
- 5) Emri i shkurtuar akronimi i **aak** në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze është: **aak** - me shkronja të vogla.
- 6) **aak** e ka shenjën, emblemën dhe vulën.
- 7) **aak** e ka web faqen publike në internet,
- 8) **aak** e ka e-mailin zyrtar me të cilin komunikon në mënyrë zyrtare.
- 9) **aak** e ka revistën **a®k**.

## QËLLIMET DHE DETYRAT

### Neni 4

**aak** vepron në mënyrë të pavarur në arritjen e qëllimeve të përcaktuara me këtë Statut dhe mund të bashkohet me shoqata të tjera dhe të antarësohet në rrjete të ndryshme në përputhje me Ligjet e Republikës së Kosovës.

### Neni 5

Qëllimet e **aak** janë:

Bashkimi i arkitektëve për krijimin dhe zhvillimin e ambientit kreativ në Kosovë. Në krijimin e zërit të përbashkët që do të flas në emër të shumicës për të gjitha çështjet me rëndësi për profesionin, shoqërinë dhe ambientin jetësor. Në zhvillimi dhe avancimi i profesionit të arkitektëve dhe statusit të tyre në shoqëri duke ruajtur reputacionin e profesionit, nderin dhe të drejtat e arkitektëve, njëkohësisht duke iu mundësuar dhe avancuar kushtet për ushtrimin e profesionit të arkitektit në mënyrë cilësore. Në avancimin e infrastrukturës ligjore për profesionin e arkitekturës. Në realizimin e interesave të gjëra dhe të përgjithshme shoqërore përmes profesionit të arkitekturës. Në promovimin e ruajtjes së vlerave të trashëgimisë së tërësive urbane, arkitektonike dhe vlerave të tjera shpirtërore e materiale të kulturës së vendit. Në etëdijesimin për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit përmes formave të ndryshme të angazhimit dhe promovimin e urbanizmit dhe të arkitekturës së gjelbër. Në avancimin e interesave të profesionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

### Neni 6

Për realizimin e qëllimeve, **aak** do të angazhohet që të bëjë:

- 1) organizimin e takimeve profesionale, seminareve, trajnimeve dhe konferencave;
- 2) përcjellje, shqyrtim dhe të marr pjesë në grupe punuese në hartimin e infrastrukturës ligjore për profesionin e arkitektit;
- 3) bashkëpunim me organizata për qëllime të avancimit të profesionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- 4) organizim të fushatave të lobimit për qëllimet e interesit të profesionit dhe të **aak** ;
- 5) botimin i fletushkave dhe revistave profesionale;
- 6) promovimin e profesionit përmes mediave;
- 7) përgatitjen dhe organizim të konkurseve në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit;
- 8) promovimin dhe ruajtjen e vlerave të pronës intelektuale dhe autoriale;
- 9) aktivitete të tjera në përputhje me qëllimet e **aak** dhe në pajtim me ligjin;
- 10) ndarjen e çmimeve vjetore për arkitekturë dhe çmimeve të tjera të përshtatshme për arritje të veçanta në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit;
- 11) trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm të anëtarëve dhe arkitektëve për të qëndruar në trendet bashkëkohore të zhvillimit profesional;

## ANËTARSIA

### Neni 7

Në **aak** kanë të drejtë të anëtarsohen të gjithë arkitektët të cilët i plotësojnë kriteret për anëtarim pa diskriminim race, gjinie, religjioni, kombësie, moshe dhe aftësie fizike.

### Neni 8

Anëtarët e **aak** mund të kenë statusin e anëtarit të:

- A. rregullt;
- B. ndërlidhur dhe
- C. nderi.

### Neni 9

Për rastet e veçanta anëtarimi do të bëhet përmes rregullores së veçantë.

### Neni 10

Anëtar të rregullt të **aak** mund të bëhen arkitektët të cilët:

1. gjatë studimeve profesionale kanë arritur gradën akademike me sukses prej min 300 kredive ECTS (5 vite studim) në ndonjërin prej institucioneve universitare të akredituara në Kosovë, ose jashtë vendit;
2. tregojnë integritet personal dhe respektojnë Kodin Etik.
3. janë të angazhuar gjatë gjithë kohës me profesionin e arkitekturës.

### Neni 11

Anëtar i ndërlidhur i **aak** i ka këto kategori:

- B.1 Bachelor, mund të bëhet personi që ka arritur gradën bachelor në studimet të Arkitekturës në ndonjërin prej institucioneve universitare të akredituara në Kosovë dhe jashtë vendit me min 180ECTS.
- B.2 Student, mund të bëhet personi që vijon studimet e arkitekturës në ndonjërin prej institucioneve universitare të akredituara në Kosovë dhe jashtë vendit.
- B.3 Ndërkombëtar mund të bëhet arkitekti i ndonjë vendi të botës i cili në vendin e vet ose në Kosovë është i angazhuar gjatë gjithë kohës në profesionin e arkitekturës dhe tregon dëshirë që të përfitoj njohuri dhe eksperiencë me rrjetëzim në **aak**.

### Neni 12

Anëtar i nderit mund të bëhet secili person i cili me angazhimin e vetë ka kontribuar në zhvillimin e arkitekturës dhe urbanizmit.

#### Neni 13

Obligimet e anëtarëve janë:

- 1) që të punojnë në përmbushjen e qëllimeve dhe të detyrave të **aak**;
- 2) që të respektojnë dhe zbatojnë Statutin e **aak** dhe Kodin Etik të Arkitektit;
- 3) që të marrin pjesë dhe mbështesin aktivitetet e **aak**;
- 4) që të punojnë në përsosjen dhe edukimin e vazhdueshëm profesional.
- 5) që në mënyrë të rregullt t'i kryejnë obligimet ndaj **aak**.

#### Neni 14

Anëtarësimi bëhet me plotësimin e kushteve të statusit gjegjës dhe:

- 1) Për kandidatët për statusin e rregullt, duhet të kenë një rekomandim prej njërit nga anëtarët e rregullt ose të merituar të **aak** që tregon se kandidatët janë dëshmuar në profesion dhe kanë respektuar Kodin Etik profesionale gjatë punës së tyre;
- 2) Për kandidatët për statusin e ndërlidhur duhet të kenë një rekomandim prej njërit nga anëtarët e rregullt, të merituar të **aak** ose të ndërlidhur, që tregon se kandidatët janë dëshmuar në profesion dhe kanë respektuar Kodin Etik profesional gjatë punës së tyre;

Propozimi shqyrtohet nga Kryesia ose Këshilli të cilin mund ta caktojë ajo dhe e bën miratimin ose refuzimin sipas rregullores për anëtarësi.

#### Neni 15

Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të merituar dhe të nderit mund ta jep secili anëtar i rregullt i **aak**. Propozimi shqyrtohet nga Kryesia dhe Këshilli të cilin mund ta caktojë ajo dhe miratimin e bën Kuvendi i **aak** sipas rregullores për anëtarësi.

#### Neni 16

Sekretari i **aak** në Zyrën Ekzekutive, mban regjistrin e anëtarësisë me të dhënat e anëtarëve, bën evidencën dhe përditësimin e tijë.

#### Neni 17

Regjistri i të dhënave duhet të përmbaj emrin dhe mbiemrin e anëtarit, ditëlindjen, adresën, vendbanimin, statusin e anëtarit, të dhënat për arritje akademike (kopjet e diplomave/certifikatave), licencat, një fotografi, kontaktet me telefon dhe elektronike, CV, pagesa e anëtarësisë, donacionet dhe kontributet nëse ka.

#### Neni 18

Secilit anëtar do ti jepet kartela e anëtarësisë me identitet personal dhe të statusit dhe kategorisë në afat dhe formë sipas rregullores për anëtarësi.

#### Neni 19

Pagesa e anëtarisë është kusht për anëtarim dhe mbajtjen e statusit të anëtarit të **aak**.

- 1) Tarifa është parapagim i anëtarisë vjetore dhe bëhet sipas Statuseve dhe Kategorive.
- 2) Statusi C. i anëtarisë së nderit nuk ka tarifë (ose tarifa është 0).
- 3) Tarifat, afatet dhe mënyra e pagesës së anëtarisë do të përcaktohen me rregullore për anëtarësi.

#### Neni 20

- 1) Anëtarësi në **aak** ndërpritet me:
  - a) mospagesë të anëtarisë për një vit e më shumë;
  - b) dorëheqje me kërkesë personale
  - c) përjashtim;

#### Neni 21

Anëtarësi mbaron me vdekjen e anëtarit

#### Neni 22

Zyrja Ekzekutive e **aak** do të lajmërojë anëtarin të cilit i ndërpritet anëtarësi mbrenda afatit të caktuar sipas rregullores për anëtarësi.

#### Neni 23

Kundër vendimit për përjashtimin nga anëtarësi, anëtarësi mund të paraqesë ankesë me shkrim mbrenda afatit të caktuar sipas rregullores për anëtarësi.

### ORGANIZIMI

#### Neni 24

Struktura organizative e **aak** është:

- i) Kuvendi;
- ii) Kryetari dhe Kryesia;
- iii) Këshilli Disiplinor;
- iv) Këshilli i Regjioneve;
- v) Këshilli i Grupeve të Punës;
- vi) Këshilli Mbikëqyrës;
- vii) Sekretari dhe Zyrja Ekzekutive;

### KUVENDI

#### Neni 25

Kuvendi është organi më i lartë udhëheqës i **aak**.

- 1) Kuvendin e përbëjnë vetëm anëtarët me status të rregullt (A.) të **aak**.
- 2) Kuvendi përbëhet prej delegatëve dhe Kryesisë.
- 3) Anëtarët e **aak** i arrijnë qëllimet e tyre nëpërmjet delegatëve si përfaqësues të tyre të përzgjedhur në organet e **aak**, dhe në mënyra të tjera të punës të përcaktuara me Statut dhe Rregulloret e **aak**.

#### Neni 26

Anëtarët e rregullt të **aak** përzgjedhin delegatët sipas çelësit në vijim:

- 1) Grupi bazë prej së paku pesë (5) anëtarë të rregullt emëron një delegat në Kuvend,
- 2) Për t'u emëruar delegat në Kuvendin e **aak**, anëtari i rregullt i **aak** duhet të sjellë dëshmi në formë të shkruar -Dekleratë për emërim më nënshkrime autentike nga grupi bazë prej të paktën pesë (5) anëtarë të rregullt.
- 3) Për punën e tyre në Kuvend, delegatët japin përgjegjësi grupeve bazë të tyre të cilat i kanë deleguar ata;
- 4) Mandati i delegatëve zgjatë tri vjet, me mundësi të rizgjedhjes.
- 5) Numri i grupit bazë që delegojnë një delegat në Kuvend me kohë mund të ndryshoj- të rritet apo të zvogëlohet varësisht prej numrit të anëtarëve të rregullt të **aak**, në mënyrë që të ruhet numri i arsyeshëm i delegatëve në Kuvend.
- 6) Kushtet dhe metodat e delegimit dhe mënyrat e zgjedhjes në Kuvend të **aak** janë përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

#### Neni 27

Grupi bazë mund të revokojë delegatin që e përfaqëson në Kuvendin e **aak**, në qoftë se nuk është i kënaqur me punën e tij për çka është i obliguar ta njoftojë Kryesinë e **aak** me shkrim.

#### Neni 28

Në rast të dorëheqjes së delegatit, grupi bazë mund të emërojë një delegat tjetër, për çka është i obliguar ta njoftojë menjëherë Kryesinë e **aak** me shkrim.

#### Neni 29

Kompetencat e Kuvendit janë:

- 1) të miratojë politikat qeverisëse të Kryesisë së **aak** në pajtim me këtë Statut dhe ligjin në fuqi;
- 2) të miratojë buxhetin dhe aprovojë raportet financiare dhe narrative të **aak**;
- 3) të miratojë të gjitha rregulloret e brendshme të **aak**;
- 4) të miratojë programet e angazhimit të **aak**;
- 5) të vendosë për statuse dhe kategori të reja të anëtarësisë apo t'i hjek ato;
- 6) të vendosë mbi ndryshimet e Statutit;
- 7) të vendosë për politikat e punësimit në Zyrën Ekzekutive të **aak**;
- 8) të vendosë mbi shuarjen apo bashkimin e **aak** me ndonjë Shoqatë tjetër;



- 9) të vendosë për shpërndarjen e aseteve të **aak** pas shpërbërjes së saj;
- 10) të vendosë mbi emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Kryesisë apo shpërbërjen e tij;
- 11) të aprovojë ndryshoj dhe plotësoj Kodin Etik të Arkitektëve;
- 12) të aprovojë çdo transaksion të **aak** që tejkalon shumë prej 10 000 €;
- 13) të aprovojë tarifat e anëtarësisë së **aak**;
- 14) të aprovojë tarifat e shërbimeve që **aak** i bën me palët
- 15) të vendosë për themelimin e çmimeve të shërbimeve profesionale;
- 16) të vendosë për emërimet për anëtar nderi dhe anëtar të merituar.
- 17) të marr vendime për anëtarësim në organizata ndërkombëtare;
- 18) të bëjë dhënien e një interpretim autentik të dispozitave të Statutit të **aak** dhe Rregulloreve të miratuara nga Kuvendi.

Neni 30

Mbledhjet e Kuvendit të **aak** janë Mbledhjet e Rregullta, Mbledhjet Zgjedhore dhe Mbledhjet e Jashtëzakonshme.

- 1) Mbledhjet e rregullta të Kuvendit do të mbahen një herë në vit. Data e mbajtjes së Mbledhjes së rregullt të Kuvendit caktohet nga Kryesia e **aak**.
- 2) Mbledhjet Zgjedhore të Kuvendit mbahen çdo dy (2) vite.
- 3) Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit mund të thirren nga më shumë se 1/2 e delegatëve të Kuvendit, me apo pa kërkesë të Kryesisë, kur për këtë ekzistojnë arsye të justifikueshme dhe që kanë të bëjnë me marrjen e ndonjë vendimi për të cilin është i autorizuar vetëm Kuvendi.
- 4) Të gjithë vendimet e Kuvendit merren në formë të shkruar;
- 5) Kuorumi për vendimmarrje të Kuvendit ekziston kur në Kuvend marrin pjesë më tepër se gjysma e delegatëve të **aak**.
- 6) Të gjitha vendimet e Kuvendit do të merren me 2/3 e votave të delegatëve që janë prezent në mbledhjen e Kuvendit. Përfundimisht, dispozitat e këtij Statuti do të përcaktojnë ato vendime për të cilat do të nevojitet vota pozitive e 2/3 të të gjithë delegatëve të Kuvendit.
- 7) Delegatët e Kuvendit ftohen në mënyrë të rregullt, me shkrim/ thirrje elektronike, së paku 15 ditë para mbajtjes së mbledhjes së rregullt të Kuvendit, dhe 30 ditë para mbajtjes së mbledhjes zgjedhore të Kuvendit. Thirrjes për mbledhje të Kuvendit i bashkëngjitet rendi i ditës dhe çdo raport i cili dorëzohet në shqyrtim dhe vendimmarrje për delegatët e Kuvendit. Mbledhjet e Kuvendit do të mbahen në hapësirat e angazhuara nga Sekretari(Drejtori Ekzekutiv). Ftesat për mbledhjen e Kuvendit i përgatitë dhe i dorëzon Sekretari.
- 8) Çdo delegat i Kuvendit ka për obligim të informojë delegatët e tjerë mbi ekzistimin e konfliktit të interesit për ndonjë çështje e cila do të vendoset në mbledhjen e Kuvendit. Delegati i Kuvendit me konflikt interesi në ndonjë çështje të caktuar për vendimmarrje nga Kuvendi nuk do të votojë për atë çështje. Konflikt interesi nënkupton situatën kur delegati i

- Kuvendit apo të afërmit dhe familjarë të tij mund të kanë interes personal apo ekonomik nga çështja e caktuar.
- 9) Delegatët e Kuvendit janë të obliguar që të tregojnë lojalitet ndaj **aak**, të mbrojnë interesat e saj, të ushtrojnë funksionin e anëtarit të Kuvendit me mirëbesim dhe kujdes dhe të mbrojnë fshehtësinë e informatave jopublike të **aak**.
  - 10) Në çdo mbledhje të Kuvendit caktohet Komisioni i punës së Kuvendit për udhëheqjen e mbledhjes. Komisioni i punës i Mbledhjes së Kuvendit është përgjegjëse për përpilimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, kurse vendimet e dala nga Kuvendi, në emër të delegatëve të Kuvendit i nënshkruan Kryetari dhe Sekretari i **aak**.
  - 11) Procesverbalet nga mbledhja e Kuvendit do t'i dorëzohen për nënshkrim, në mënyrë elektronike secilit delegat pjesëmarrës në afat prej 5 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes. Delegatët do t'i përgjigjen kërkesës për nënshkrimin e procesverbalit në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të tij. Mosnënshkrimi i procesverbalit, pa arsye për kundërshtimin e përmbajtjes së tij, do të konsiderohet si pranim i tij.
  - 12) Mbledhjet e delegatëve të Kuvendit do të inçizohen në mënyrë audio.
  - 13) Një vendim i natyrës urgjente i kualifikuar si i tillë nga ana e Kryesisë apo edhe i paraparë me dispozitat e Statutit mund të votohet nga ana e delegatëve të Kuvendit edhe në mënyrë elektronike. Kërkesa për miratimin e vendimit duhet t'u dërgohet të gjithë delegatëve të Kuvendit, kurse Vendimi konsiderohet i miratuar nëse është votuar *pro* vendimit në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të nenit këtij neni. Për qëllime të këtij paragrafi "prezent" sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni do të nënkuptojë delegatët që i janë përgjigjur kërkesës në mënyrë elektronike.
  - 14) Të gjitha vendimet e Kuvendit do të arkivohen në Zyrën Ekzekutive në selinë e **aak** dhe do të mirëmbahen nga Sekretari.
  - 15) Vendimet e Kuvendit mund t'u ipen në shiqim çdo anëtar i rregullt të interesuar të **aak**;
  - 16) Mbledhjet e Kuvendeve Vjetore mund të jenë, por jo domosdo, të hapura pjesërisht ose tërësisht (çdo pjesë e mbledhjes) për anëtarët e të gjitha statuseve, gjë për të cilën do të vendos Kryesia ose Kuvendi paraprakisht ose gjatë mbajtjes së mbledhjes.
  - 17) Mbledhjet Zgjedhore dhe të Jashtëzakonshme të Kuvendit nuk janë të hapura për antarësinë e gjerë dhe publikun.
  - 18) Në rast se për ndonjë mbledhje Kuvendi nuk arrinë numrin e duhur të delegatëve atëherë ai automatikisht shtyhet për një periudhë 15 ditëshe kur Kuvendi duhet të mbledhet me rendin e njejtë të ditës.

#### Neni 31

- 1) Kuvendi në parim vendos me votim publik.
- 2) Kuvendi mund të vendosë që në raste të caktuara, votimi të jetë votim i fshehtë.
- 3) Vendimi për zgjedhjen apo shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarve të Kryesisë gjithmonë do të bëhet me votim të fshehtë.

## KRYESIA DHE KRYETARI I aak

### Neni 32

Kryesia e **aak** qeverisë me organizatën dhe përbëhet prej Kryetarit, Nënkryetarit, Kryetarit të Këshillit Disiplinor, Kryetarit të Këshillit të Regjioneve dhe Kryetarit të Këshillit të Grupeve të Punës.

### Neni 33

Kryesia e **aak**:

- 1) Përcakton vizionin dhe misionin e **aak** dhe orienton në arritjen e qëllimeve të caktuara në Statut;
- 2) Përcakton dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe të strategjive të qeverisjes për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të **aak** jo vetëm mbrenda mandatit kohor të caktuar me Statut.
- 3) Zbaton vendimet e Kuvendit;
- 4) Sipas nevojës, për qeverisje sa më të mirë të **aak**, inicon dhe punon në amandamentimin e Statutit dhe të rregulloreve për aprovim nga Kuvendi;
- 5) Miraton rregulloret e procedurës përveç atyre që i miraton Kuvendi, si dhe ndryshimet e tyre dhe amandamentet;
- 6) Për punën e sajë jep përgjegjësi dhe i raporton Kuvendit një here në vit.
- 7) I propozon Kuvendit projekt-programin vjetor dhe afat-gjatë të **aak**;
- 8) I propozon Kuvendit miratimin e planit financiar dhe miratimin e llogarisë përfundimtare, diskuton çështjet financiare të **aak**, merr vendime mbi financimin e përkohshëm deri në miratimin e planit financiar dhe merr në konsideratë dhe miraton pasqyrat financiare periodike;
- 9) Vendos për thirrjen e Kuvendit, dhe përgatit dhe organizon punën e tij;
- 10) Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillave;
- 11) Shqyrton dhe miraton propozimet e Këshilleve;
- 12) Emëron komisionin për zgjedhjen e Sekretarit ( Drejtorit Ekzekutiv të **aak**) me anë të konkursit;
- 13) Në rast të mospërbushjes së detyrave e shkarkon Sekretarin;
- 14) Miraton Rregulloren e punës së Zyrës Ekzekutive(ndryshimet e saja), e cila përcakton mënyrën e organizimit të punës, sistematizimi e vendeve të punës, punës dhe detyrave të Zyrës Ekzekutive si dhe shërbimeve profesionale të **aak**.
- 15) Mbikëqyrë punën e Sekretarit dhe të Zyrës Ekzekutive;
- 16) Merr vendime për propozimin e anëtarëve për anëtarësim në **aak**;
- 17) Merr vendime për propozimet, kërkesat e anëtarësisë në nivelin e statuseve;
- 18) Emëron delegatë për organizata dhe organe të tjera,
- 19) Nxiti dhe zhvillon bashkëpunim me Odën e Arkitektëve të Kosovës;
- 20) Nxiti dhe zhvillon bashkëpunimin me organizata të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare;

- 21) Ka për detyrë të jap informata të duhura Këshillit Mbikëqyrës për qëllime të ndërmarrjes së veprimeve për të eliminuar defektet;
- 22) Sipas nevojës merr vendime në lidhje me organizimin e ngjarjeve kryesore: kongrese, simpoziume, konferenca, konferenca shkencore dhe të tjera, ekspozita dhe udhëtimet profesionale për anëtarët e saj;
- 23) Koordinon punën e anëtarëve të **aak**;
- 24) Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara në Statut.

#### Neni 34

Kryetari zgjedhet nga Kuvendi i **aak** me shumicë votash, me votim të fshehtë të delegatëve. Mandati i Kryetarit zgjat 2 (dy) vjet me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat (2+2).

#### Neni 35

Kryetari i **aak**:

- 1) Përfaqëson **aak**,
- 2) E udhëheq Kryesinë e **aak**.
- 3) Vendos dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë së **aak**.
- 4) Siguronë zbatimin e vendimeve dhe përfundimeve të Kryesisë dhe Kuvendit ;
- 5) Kujdeset për zbatimin e Statutit dhe akteve të përgjithshme;
- 6) Nënshkruan vendimet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kryesia dhe Kuvendi;
- 7) Bën thirrjen e mbledhjeve të Kryesisë dhe të Kuvendit;
- 8) Mbikëqyrë transaksionet financiare,
- 9) Nënshkruan kontratën për angazhimin e Sekretarit;
- 10) Kujdeset për shpenzimin racional, efektiv dhe përdorimin e duhur të fondeve,
- 11) Nëse është e nevojshme, i jep autorizime palëve të treta për përfaqësim të caktuar të **aak**.
- 12) Kryen detyra të tjera të përcaktuara me Statut dhe aktet e përgjithshme.

#### Neni 36

Kandidati për Kryetar të **aak** duhet:

- 1) Të jetë anëtar i rregullt i **aak** me së paku 5 vite anëtarësie pandërprerje;
- 2) Të jetë i shquar me integritetin personal dhe respektimin e Kodit Etik;
- 3) Të jetë i shquar me punën e vetë si arkitekt;
- 4) Të sjell dëshmi në formë të shkruar “Deklaratë për kandidat” me nënshkrime autentike nga grupi prej të paktën njëzet(20) anëtar të rregullt;
- 5) Të jap në formë të shkruar mënyrën se si do të qeveriset **aak** gjatë mandatit që ai do të udhëheq më të;

#### Neni 37

- 1) Kryetari i **aak** propozon kandidatët për Kryesinë e **aak** në përbërje: Nënkyetar, Kryetar të Këshillit Disiplinor, Kryetar të Këshillit të Regjioneve dhe Kryetar të Këshillit të Grupeve të Punës. Propozimi si pako duhet të votohet prej Kuvendit me shumicë votash, me votim të fshehtë.
- 2) Mandati i Kryesisë zgjat 2(dy) vjet me mundësi të rizgjedhjes edhe vetëm për një mandat (2+2).

#### Neni 38

Nënkyetari do të zëvendësojë Kryetarin e **aak** në rast të mungesës së tijë.

#### Neni 39

- 1) Në rast të dorëheqjes së Kryetarit zëvendësimin do ta bëjë Nënkyetari ose njëri prej anëtarëve të Kryesisë deri në Mbledhjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm Zgjedhor, në të cilin do të aprovohet dorëheqja dhe bëhet zgjedhja e Kryetarit dhe të Kryesisë së re brenda afatit prej 60 ditë.
- 2) Në rast të dorëheqjes ose shkarkimit të Nënkyetarit , Kryetari i **aak** do të bëjë zëvendësimin e tijë me njërin prej Kryetarëve të Këshilleve deri në zgjedhjen e Nënkyetarit të ri nga Kuvendi me propozimin e Kryetarit të **aak**.
- 3) Në rast të dorëheqjes ose shkarkimit të Kryetarëve të Këshillit Disiplinor, të Këshillit të Regjioneve dhe Këshillit të Grupeve të Punës, Kryetari i **aak** bën emërimin e zëvendësimit të tyre me nënkyetarët e Këshilleve deri në zgjedhjen e Kryetarëve të ri të Këshilleve nga Kuvendi me propozimin e Kryetarit të **aak**.

#### Neni 40

- 1) Lista zgjedhore me kandidatë për anëtar të kryesisë duhet të jetë e dorëzuar në Zyrën Ekzekutive të **aak** jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para mbajtjes së Mbledhjes Zgjedhore të Kuvendit.
- 2) Lista zgjedhore do të jetë në dispozicion të anëtarësisë, kështu që delegatët e Kuvendi dhe anëtarët duhet të informohen nëpërmjet web faqes së **aak** dhe postës elektronike ose tabelës së lajmërimeve për të paktën 15 ditë para Mbledhjes së Kuvendit.
- 3) Lista Zgjedhore duhet të përmbajë listën e kandidatëve me të dhëna të mjaftueshme personale, dhe me programin e propozuar të punës për periudhën prej dy vjetësh.

#### Neni 41

- 1) Mbledhjet e Kryesisë i thërret dhe i kryeson Kryetari i **aak**.
- 2) Mbledhjet e Kryesisë mund të mbahen edhe në lokacione të tjera jashtë selisë së **aak** dhe mund të janë me karakter publik.

- 3) Minimumi i mbledhjeve që do të mbahen gjatë një viti është katër (4, të shpërndara në çdo tre muaj) ku prania e anëtarëve të kryesisë nuk mund të jetë më e vogël se tre (3) anëtarë.

#### Neni 42

Kryesia në mbledhjet e saja merr vendime të plotëfuqishme nëse janë prezent së paku tre(3) anëtarë të Kryesisë së **aak**. Vendimet e merren me votim ose ashtu si mund ta përcaktojhet në mbledhjen e Kryesisë.

#### Neni 43

Anëtarët e Kryesisë të cilët nuk janë në gjendje të marrin pjesë në mbledhje, mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes nëpërmjet një konference audio-vizuale. Në këtë rast, vendimet merren me shumicën e votave të të pranishmëve përfshirë edhe anëtarët pjesëmarrës në Konferencën audiovizuale.

Dispozita e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen në rastet e mëposhtme:

- 1) Marrja e vendimeve me votim të fshehtë,
- 2) Konfirmimi ose shkarkimi i Sekretarit.

#### Neni 44

Mënyra e punës së Kryesisë përcaktohet me Rregulloren e punës së Kryesisë në përputhje me Statutin, të miratuar nga Kuvendi.

#### Neni 45

Kryetari mund të shkarkohet nëse nuk i kryen detyrat nga neni 35 në mënyrë të kënaqshme. Propozimin për shkarkim mund ta paraqet grupi prej 2/3 e delegatëve të Kuvendit, kurse vendimin për shkarkim e tij e merr Kuvendi. Shkarkimi do të miratohet me shumicën e votave të të pranishmëve në Mbledhjen e Kuvendit dhe merret me votim të fshehtë. Nëse shkarkimi votohet atëherë Kuvendi do të emërojë një ushtrues detyre deri në Mbledhjen Zgjedhore të Kuvendit që duhet të mbahet mbrenda 60 ditëve.

#### Neni 46

Anëtarët e Kryesisë mund të shkarkohen nëse:

- 1) nuk respektojnë ose nuk ekzekutojnë vendimet e Kryesisë;
- 2) nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Kryesisë (tri takime rresht) mbrenda vitit kalendarik;
- 3) pamundësojnë ose pengojnë Kryesinë dhe organet e tjera të **aak** në realizimin e qëllimeve të parapara me këtë Statut.
- 4) nuk i përfillin dispozitat e këtij Statuti dhe të akteve tjera të **aak** edhe pasi të jenë paralajmëruar nga Këshilli Mbikëqyrës;

#### Neni 47

E tërë Kryesia mund të shkarkohet para skadimit të mandatit për të cilinë ata janë zgjedhur në rastet kur:

- 1) Kryesia nuk zbaton vendimet e Kuvendit;
- 2) Nuk ia paraqet Kuvendit raportin mbi punën e vet;
- 3) Nuk i përfillë dispozitat e këtij Statuti dhe të akteve tjera të **aak** edhe pasi të jenë paralajmëruar nga Këshilli Mbikëqyrës;
- 4) Nëse nuk mbahen mbledhjet e rregullta të Kryesisë për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj (2 mbledhje tre mujore).

#### Neni 48

- 1) Propozimi për shkarkimin e Kryesisë mund të inicohet nga 1/2 e delegatëve të Kuvendit të **aak**.
- 2) Revokimi do të miratohet me 2/3 e votave të të gjithë delegatëve të Kuvendit të arritur me votim të fshehtë.
- 3) Mandati i anëtarit të sapozgjedhur të Kryesisë zgjat deri në fund të afatit të caktuar të paraardhësit në pozitën e anëtarit të Kryesisë.

#### Neni 49

Kryesia e re duhet të zgjidhet mbrenda periudhës prej 30 ditësh nga data e revokimit.

#### Neni 50

Kryesia e sapozgjedhur në rastin e revokimit të Kryesisë së Vjetër e vazhdon mandatin dy vjeçar të Kryesisë së kaluar nga dita e zgjedhjes.

### KËSHILLI MBIKËQYRËS

#### Neni 51

Këshilli Mbikëqyrës është trup i **aak** i cili monitoron dhe kujdeset për mbrojtjen e parimeve të menaxhimit të mirë dhe të mardhënieve demokratike në punën e **aak**. Ai mbikëqyrë dhe raporton në lidhje me aktivitetet materiale dhe financiare; e në mënyrë të veçantë:

- 1) Monitoron dhe raporton zbatimin e Statutit dhe akteve tjera të **aak**;
- 2) Monitoron dhe raporton për miratimet dhe zbatimet e vendimeve të Kuvendit, Kryesisë, Kryetarit, nënkryetarëve, Këshillit Disiplinor, Këshillit të Regjioneve dhe të Këshillit të Grupeve të punës në **aak**.

#### Neni 52

Të gjithë anëtarët, punonjësit dhe strukturat e **aak** i detyrohen Këshillit Mbikëqyrës që tu sigurojnë qasje në të gjitha dokumentet në lidhje me funksionimin e **aak**.

#### Neni 53

- 1) Këshilli Mbikëqyrës ka tre anëtarë, të zgjedhur nga delegatët e Kuvendit.
- 2) Anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrës mes vete zgjedhin Kryetarin dhe Nënkryetarin e Këshillit Mbikëqyrës
- 3) Mandati i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës do të zgjatë dy vjet, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.
- 4) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të organeve të tjera të **aak**.

#### Neni 54

- 1) Këshilli Mbikëqyrës sipas nevojës mund të themeloj grupe të punës sipas nevojës dhe në pajtim me Kryesinë;
- 2) Këshilli Mbikëqyrës do të paralajmëroj Kryesinë dhe Kuvendin për mosfunksionim apo shkellje dhe të kërkojë nga të njejtit që të evitojnë mbrenda një afati kohor të caktuar.
- 3) Autoritetet e paralajmëruara të **aak** do të njoftojnë Këshillin Mbikëqyrës për veprimet e ndërmarra në mënyrë që të shmangen parregullësitë dhe të bëhet korigjimi i defekteve të evidentuara.

#### Neni 55

Këshilli Mbikëqyrës duhet të paktën një herë në vit, para miratimit të llogarisë përfundimtare dhe afarizmit të **aak** të shqyrtojë situatën e menaxhimit material dhe financiar të **aak**.

#### Neni 56

- 1) Këshilli Mbikëqyrës për punën e tij është përgjegjës para Kuvendit, të cilit të paktën një herë në vit ia paraqet një raport mbi punën e vet.
- 2) Këshilli Mbikëqyrës merr vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

#### Neni 57

Metodat e punës së Këshilli Mbikëqyrës të përcaktohet me Rregulloren e Punës së Këshilli Mbikëqyrës, e cila është në përputhje me Statutin e miratuar nga Kuvendi.

### KËSHILLI DISIPLINOR

#### Neni 58

- 1) Këshilli Disiplinor zgjidh situatat që shkaktojnë anëtarët e **aak** me mosrespektimin e Statutit të **aak** dhe Kodit Etik Profesionale të arkitektëve.



- 2) Këshilli Disiplinor jep interpretimin e drejtë të çdo paqartësie që mund të dal nga Statuti, Rregulloret dhe dokumentet relevante të **aak**.

#### Neni 59

- 1) Këshilli Disiplinor përbëhet prej tre (3) anëtar.
- 2) Kryetari i Këshillit Disiplinor propozohet nga Kryetari i **aak** dhe votohet në Kuvend, nënkryetari dhe anëtari tjetër zgjedhen nga delegatët e Kuvendit me votim.
- 3) Mandati i Këshillit Disiplinor është dy vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

#### Neni 60

- 1) Këshilli Disiplinor për punën e tij është përgjegjës para Kryesisë dhe Kuvendit, si dhe duhet të paktën një herë në vit ti paraqesë raportin mbi punën e vet.
- 2) Këshilli Disiplinor merr vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

#### Neni 61

Këshilli Disiplinor jep dhe shqipton masën e paralajmërimit për përjashtim apo të përjashtimit nga anëtarësimi.

#### Neni 62

Mënyra e punës së Këshillit Disiplinor përcaktohet me Rregulloren e Punës së Këshillit Disiplinor e cila është në përputhje me Statutin e miratuar nga Kuvendi.

### KËSHILLI I REGJIONEVE

#### Neni 63

Këshilli i Regjioneve përbëhet prej shtatë(7) anëtarëve të Kuvendit përfaqësues të shtatë (7) regjioneve të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan.

#### Neni 64

Këshilli i Regjioneve meret me organizimin e **aak** nëpër regjione duke i mbledhur anëtarët e sajë në bashkësi të komunave për një menaxhim më të sukseshëm dhe përfaqësim të secilit qytet të Kosovës në Kuvendin dhe punën e **aak**.

#### Neni 65

Këshilli i Regjioneve përbëhet nga kryetari dy (2) nënkryetar dhe katër (4) anëtar. Kryetari i Këshillit të Regjioneve propozohet nga Kryetari i **aak** dhe votohet në Kuvend, dy (2) nënkryetarët dhe anëtarët zgjedhen nga delegatët e Kuvendit me votim.

Neni 66

Mandati i Këshillit të Regjioneve është dy vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

Neni 67

- 1) Këshilli i Regjioneve për punën e tij është përgjegjës para Kryesisë dhe Kuvendit, si dhe duhet të paktën një herë në vit t'ia paraqesë raportin mbi punën e vet.
- 2) Këshilli i Regjioneve merr vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 68

Mënyra e punës së Këshillit të Regjioneve do të përcaktohen me Rregulloren e Punës së Këshillit të Regjioneve e cila është në përputhje me Statutin e miratuar nga Kuvendi.

Neni 69

Këshilli i Regjioneve mund të organizohet si union i **aak** të qyteteve të Kosovës në 7 regjione dhe si të tillë këto mund ti bëjnë statutet e veta duke qëndruar mbrenda kufizimeve të Statutit të **aak**.

## KËSHILLI I GRUPEVE TË PUNËS

Neni 70

Kryesia dhe Kuvendi i **aak** mund të themelojnë grupe të ndryshme të punës sipas nevojës, të cilat për punën e vet do të japin përgjegjësi Këshillit të Grupeve të Punës dhe të cilit duhet t i paraqesin raporte periodike min një(1) here në vit mbi punën e tyre.

Neni 71

- 1) Anëtarët e grupeve të punës zgjedhen nga Këshillit të Grupeve të Punës e **aak** për një periudhë kohore të caktuar nga mesi i anëtarëve të **aak**.
- 2) Secili Grup i punës e ka udhëheqësin e vet dhe zëvendësin.
- 3) Numri i anëtarëve të grupit të punës dhe mënyra e punës përcaktohet me Rregulloren e punës së grupeve të punës.

Neni 72

- 1) Këshilli i Grupeve të Punës përbëhet prej tre (3) anëtar.
- 2) Kryetari i Këshillit të Grupeve të Punës propozohet nga Kryetari i **aak** dhe votohet në Kuvend, nënkryetari dhe anëtari tjetër zgjedhen nga delegatët e Kuvendit me votim.
- 3) Mandati i Këshillit të Grupeve të Punës është dy vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

#### Neni 73

Mënyra e punës së Këshillit të Grupeve të Punës dhe numri i anëtarëve të grupit të punës dhe mënyra e punës së tyre do të përcaktohen me Rregulloren e Punës së Këshillit të Grupeve të Punës e cila është në përputhje me Statutin e miratuar nga Kuvendi.

### PASURIA DHE MËNYRA E POSEDIMIT

#### Neni 74

Asetet dhe fondet e **aak** mund të përfshijnë:

- 1) Të hyra të gjeneruara nga anëtarësia;
- 2) Donacionet private dhe publike;
- 3) Të hyrat e gjeneruara nga çdo aktivitet i ligjshëm i **aak**;
- 4) Asete të **aak** të krijuara për qëllime të funksionalizimit të punës së **aak**;
- 5) Të hyra të tjera, të realizuara në pajtim me ligjin.

#### Neni 75

- 1) Fondet dhe asetet e **aak** do të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e **aak** të përcaktuara me këtë Statut dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta qoftë për themeluesit, anëtarët, zyrtarët apo nëpunësit e saj. Kjo nuk përjashton pagesën e kompensimit të arsyeshëm të zyrtarët dhe nëpunësit e saj të cilët kryejnë punën për **aak**, në përputhje me kontratat e punës.
- 2) Një auditor i pavarur dhe i jashtëm, i caktuar nga Kryesia do të auditojë llogaritë e **aak** çdo vit për të verifikuar se të gjitha fondet janë përdorur nëpajtim me Statutin dhe ligjet.
- 3) **aak** nuk do të shpërndajë fitime apo pasuri për anëtarët e vet, delegatët e Kuvendit, anëtarët e Kryesisë, Zyrës Ekzekutive dhe Keshilleve apo zyrtarët e saj.
- 4) Çdo transaksion eventual në mes të **aak** dhe anëtarëve të saj, zyrtarëve, anëtarëve të Zyrës Ekzekutive apo punonjësve, nëse është i pashmangshëm, duhet të bëhet sipas vlerës reale të tregut apo me kushte sa më të favorshme për **aak**.
- 5) **aak** e ka xhirrollogarinë e vet bankare dhe përmes saj do të kryej çdo transaksion, me përjashtim të pagesave të imëta në shumat e caktuara dhe rekomanduara nga Kuvendi.
- 6) Në xhirrollogarinë bankare të **aak** do të autorizohen dy nënshkrime ajo e Kryetarit dhe e Sekretarit .

### SHUARJA E **aak** DHE TRAJTIMI I PRONËS

#### Neni 76

**aak** e shuan aktivitetin në bazë të vendimit të Kuvendit dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

#### Neni 77

Në rast të shuarjes së **aak** pas përmbushjes së obligimeve ndaj kreditorëve, shpenzimeve gjyqësore dhe të tjera procedura prona me një vendim të Kuvendit i bartet ndonje subjekti që korrespondon me aktivitetet, qëllimin dhe veprimtarinë e **aak**.

#### SEKRETARI DHE ZYRJA EKZEKUTIVE E aak

#### Neni 78

Sekretari i **aak** është Drejtori Ekzekutiv i sajë dhe përfaqësues i autorizuar i Shoqatës sipas ligjit. Punën e vet Sekretari e kryen përmes punësimit në **aak**.

#### Neni 79

Sekretari kryen detyrat e mëposhtme:

- 1) Është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së përditshme të **aak**, ekzekutimin e vendimeve të Kryesisë së **aak**.
- 2) Kujdeset për Regjistrin e anëtarëve të **aak**, dhe është përgjegjës për shërbimet që u jepen anëtarëve të **aak**.
- 3) Përfaqëson **aak** në raport me personat e tretë, pranë autoriteteve publike në Kosovë dhe jashtë vendit, pranon njoftime dhe hetime zyrtare sipas ligjit.
- 4) Udhëheq dhe organizon punën në Zyren Ekzekutive në baza ditore, bën mbikqyrjen e nëpunësve dhe punësimin dhe shkarkimin e tyre konform autorizimeve të përcaktuara me Statut dhe në konsultë me Kryesinë e **aak** bën lidhjen e kontratave;
- 5) Bën miratimin e transakcioneve të **aak** deri në vlerë prej 500 € në mënyrë vetanake.
- 6) Merr pjesë në mënyrë aktive në takimet e Donatorëve dhe benefaktorëve në vend dhe rajon dhe bën kërkimin dhe gjetjen e fondeve të duhura për operimin e **aak**.
- 7) Me anë të projekteve dhe operacioneve që i përkojnë **aak** bën kërkimin dhe aplikimin për fonde dhe mjete tek Institucionet vendore, Organizatat Joqeveritare, Organizatat Qeveritare, Donatorët, Programet Zhvillimore etj.
- 8) Sekretari është përgjegjës për të siguruar zbatimin e drejtë të programeve, të politikave dhe procedurave të Kryesisë së **aak**.
- 9) Sekretari mbikëqyr përdorimin e fondeve të **aak** mbrenda kufijve të buxhetit dhe politikave financiare të miratuara nga Kuvendi i **aak**.
- 10) Autorizimet tjera të Sekretarit do të përcaktohen edhe me Rregulloren e punës për Zyrën Ekzekutive si dhe me kontratë pune të cilin e përpilon dhe aprovon Kryesia.
- 11) Për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të veta Sekretari i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryesisë së **aak**.
- 12) Përfaqëson **aak** në aktivitetet për të cilat është autorizuar nga Kryesia e **aak**;
- 13) Përgatit projekt-vendime dhe konstatime të Kuvendit dhe të Kryesisë;
- 14) Përgatit e propozonë planin financiar dhe organizon implementimin e tij;

- 15) Nënshkruan të të gjitha dokumentet financiare;
- 16) Urdhëron transaksionet financiare;
- 17) Organizon hartimin e akteve nënligjore;
- 18) Bën organizimin e Mbledhjeve të Kuvendit;
- 19) Organizon të gjitha takimet që Kryesia e **aak** ndërmerr në aktivitetet e saja.
- 20) Merr pjesë në mbledhjet e Kryesisë kur thirret;
- 21) Përfaqëson **aak** në raporte kontraktuese me palët e treta.

## TË PUNËSUARIT NË **aak**

### Neni 80

**aak** sipas vlerësimit të Kryesisë mund të punësojë me orar të plotë apo jo të plotë edhe punonjës të tjerë që do të angazhohen në punët administrative, kontabilitetit, shërbimet e teknologjisë së informacionit, mirëmbajtje të zyres dhe punë të tjera.

### Neni 81

Për mirëmbajtjen e web faqes dhe të informative të sakta në internet për **aak** Zyrja ekzekutive do të punësojë një person tëspecializuar ose të kontraktojë kompani të specializuara për këto shërbime.

### Neni 82

Aplikimi për vendet e punës në zyrën Ekzekutive do të bëhet me konkurs dhe vendimi mbi punësimin e personave do të merret nga Kryesia e **aak**.

### Neni 83

Rregullorja e Zyres Ekzekutive përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit, sistematizimin e vendeve të punës, punët dhe detyrat e Zyrës Ekzekutive si dhe shërbimet e saja. Rregulloren, ndryshimet dhe plotësimet e saj i sjellë Kryesia e **aak** me propozim të Sekretarit.

### Neni 84

Punën e shërbimeve profesionale të zyrëtarëve të Zyrës Ekzekutive e menaxhon Sekretari i **aak**.

### Neni 85

Për punën e shërbimeve profesionale në Zyrën Ekzekutive dhe punën e vet Sekretari i përgjigjet Kryesisë të cilës i raporton të paktën dy (2) herë në vit.

### Neni 86

Sekretari për zgjedhjet me anë të konkursit të hapur të shpallur në mediat vendore. Kushtet e konkursit i përcakton Kryesia e **aak**.

#### Neni 87

Sekretari do të jetë një person i cili duhet të përmbushë këto kërkesa minimale:

- a) Diplomë universitare;
- b) Njohuri aktive të gjuhës angleze;
- c) Së paku 5 vjet përvojë pune në pozita menaxheriale.

#### Neni 88

Sekretari shkarkohet në rastet:

- a) Nëse Kryesia konstaton se punët dhe detyrat e besuara tejkalojnë kapacitetin e aftësive dhe kjo reflekton negativisht në punën e përgjithshme të **aak**;
- b) Nëse i shkel rëndë dispozitat e Statutit dhe akteve të tjera të përgjithshme;
- c) Nëse pa arsytim të bazuar refuzon të ekzekutoj vendimet e ligjshme të Kryesisë;
- d) Nuk vepron në përputhje me kërkesat e Këshillit Mbikëqyrës për eliminimin e defekteve në afarizmin e **aak** ose shkeljeve të të drejtave të punëtorëve në shërbimet profesionale të Zyrës Ekzekutive;
- e) Nëse me punën dhe veprimet e veta shkakton dëme për **aak**, ose në qoftë se për shkak të tij **aak** nuk mund t'i realizojë objektivat themelore.

### TRANSPARENCA

#### Neni 89

- 1) Për realizimin e punës në mënyrë sa më transparente të gjitha organet dhe trupat e **aak**, do të përdorin web faqen zyrtare të saj të regjistruar tek një furnitor të licencuar të shërbimeve të tilla
- 2) Parimi i transparencës arrihet duke realizuar takime publike të strukturave të **aak**

#### Neni 90

Kryetar i **aak** në emër të **aak** ka autorizim për të dhënë deklarata publike. Kryetari i **aak** dhe Kryesia mund të caktojnë ose ta punësojnë një person i cili do të merret me relacionet publike si zëdhënës i **aak**.

#### Neni 91

Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

- a) Raportet e rregullta narrative dhe financiare i prezantohen Kuvendit të anëtarëve në baza vjetore, apo edhe më shpesh, nëse kjo kërkohet nga Kuvendi i anëtarëve.
- b) Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

## NDRYSHIMET E STATUTIT, DISPOZITAT KALIMTARE DHE HYRJA NE FUQI E STATUTIT

Neni 92

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti mund të bëhen vetëm nga Kuvendi i **aak**.

Neni 93

Interpretimi autentik i dispozitave përkatëse të parashikuara me këtë Statut i jep Kuvendi.

Neni 94

Midis dy Kuvendeve interpretimin e dispozitave të Statutit dhe Rregullave të Procedurës për ndonjë rast e jep Kryesia ndërsa interpretimi autentik Kuvendi i parë i ardhshëm.

Neni 95

Interpretimi autentik i Rregulloreve dhe akteve të tjera të përgjithshme, të lëshuar nga Kryesia e **aak** e jep vetë ajo.

Neni 96

- 1) Mbledhja e Kuvendit sipas këtij Statuti (2016) do të bëhet mbrenda 180 ditëve nga dita e miratimit.
- 2) Organizimin e Mbledhjes do ta bëjë Kryesia e zgjedhur në Mbledhjen Zgjedhore të Kuvendit të **aak** më 10 Prill 2014 në Prishtinë.


Neni 97

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij nga ana e Kuvendit të **aak**.

Neni 98

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i **aak** me datë Dhjetor 1999.

Nga:



Ilir Murseli

përfaqësues i autorizuar i **aak**



asociacioni i arkitektëve të kosovës